



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AGJENCIA E AUDITIMIT TË PROGRAMEVE TË AKREDITUARA NGA**  
**BASHKIMI EVROPIAN**

**RAPORTI VJETOR I AGJENCISË SË AUDITIMIT TË PROGRAMEVE TË**  
**AKREDITUARA NGA BASHKIMI EVROPIAN**

**(AUTORITETI I AUDITIMIT)<sup>1</sup>**

---

<sup>1</sup>Sipas nenit 16 pika 2 e Ligjit Nr.90/2016

## **TABELA E PËRMBAJTJES**

- I. MISIONI I INSTITUCIONIT**
- II. AKTIVITETET KRYESORE TË VITIT 2018**
- II. VEPRIMTARIA E KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË AA**
- III. AKVITETET E AUDITIMIT**
- IV. ZHVILLIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE**
- V. STRATEGJIA AFATMESME E ZHVILLIMIT TË AA, SFIDAT PER VITIN 2018**
- VI. RELACION PËR PASQYRAT FINANCIARE**

**SHTOJCA 1- PASQYRAT FINANCIARE**

## LISTË AKRONIMESH

- AA/AAPAA-AUTORITETI I AUDITIMIT-AGJENCIA E AUDITIMIT TË PROGRAMEVE TË ASISTENCËS SË AKREDITUAR NGA BASHKIMI EVROPIAN
- KKIPA/NIPAC-KOORDINATORI KOMBËTAR I INSTRUMENTIT TË PARANËTARËSIMIT
- ZKA/NAO-ZYRTARI KOMBËTAR AUTORIZUES/I AUTORIZUAR
- SPO/HIPAU-ZYRTARI I LARTË I PROGRAMIMIT/DREJTUESI I NJËSISË IPA
- CFCU-NJËSIA E FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE
- AZHBR-AGJENCIA PËR ZHVILLIMIN BUJQËSOR RURAL/AGJENCIA E PAGESAVE
- IPA-INSTRUMENTI I PARANËTARËSIMIT
- IPARD-INSTRUMENTI I PARANËTARËSIMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL
- KE/EC-KOMISIONI EVROPIAN
- TAIB-KOMPENTI PËR ASISTENCËN TEKNIKE DHE ZHVILLIMIN INSTITUCIONAL
- DG NEAR-DEPARTAMENTI I POLITIKAVE TË ZGJERIMIT NË KOMISIONIN EVROPIAN
- DG AGRI-DEPARTAMENTI I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL NË KOMISIONIN EVROPIAN

## **PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës së Akredituar nga Bashkimi Evropian (Autoriteti i Auditimit) gjatë vitit 2018 ka përfituar nga projekti i financuar nga Bashkimi Evropian me titull “Fuqizimi i kapaciteteve të Autoritetit Shqiptar të Auditimit”.

Ky projekt i ka mundësuar Autoritetit të Auditimit të përfitojë tranime në fusha të ndryshme të auditimit, një vizitë studimore pranë strukturës tonë si-motër dhe asistencë në kryerjen e detyrave funksionale si dhe ka harmonizuar procedurat sipas standarteve ndërkombëtare.

Auditimi ka mbuluar fondet e akorduara nga Bashkimi Evropian si më poshtë:

Marrëveshja Kuadër ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian për rregullat e bashkëpunimit për ndihmën financiare të Bashkimit Evropian për zbatimin e Instrumentit të Para-Anëtarimit (IPA) 2007-2013 dhe IPA 2014-2020" me shumën totale të alokuar për Shqipërinë me marrëveshjet financiare me shumën 65,970,000 EUR të shpërndarë:

- IPA 2012 shuma 18,670,000 EUR;
- IPA 2013 shuma 12,300,000 EUR;
- IPA 2014 shuma 16,300,000 EUR;
- IPA 2015 shuma 14,200,000 EUR;
- IPA 2017 shuma 4,500,000 EUR;

Për periudhën IPA II (2014-2020) Shqipëria merr pjesë në 8 programe të Bashkëpunimit Territorial si më poshtë:

- **4 Programe Bilaterale**

- a) Interreg IPA CBC Greqi-Shqipëri 2014-2020 me një buxhet total prej 54,076,734 EUR
- b) IPA CBC Maqedoni – Shqipëri 2014-2020 me një buxhet total prej 13,790,000 EUR
- c) IPA CBC Mal i Zi – Shqipëri 2014-2020 me një buxhet total prej 13,790,000 EUR
- d) IPA CBC Shqipëri– Kosovë 2014-2020 me një buxhet total prej 9,734.118 EUR

- **Program Tri-lateral:**

- a) Interreg IPA CBC Itali – Shqipëri – Mal i Zi 2014-2020 me një shumë totale prej 93,000,000 EUR

- **3 Programe Transnacionale**

- a) Interreg ADRION (Adriatiko-Jonian) me një buxhet total prej 99.1 milion EUR
- b) Interreg Mediterranean (Mediterranean) me një buxhet total prej 233,678.791 EUR
- c) Interreg BalkanMed (Balkan-Mediterranean) me një buxhet total prej 33.456.246 EUR

Në 2018, Shqipërisë i është dhënë besimi për të zbatuar buxhetin me menaxhim indirekt për

programin IPARD duke u firmosur marrëveshja financiare ndërmjet Komisionit Evropian dhe Shqiptar me një buxhet total prej 71,000,000 EUR. Me raportet zyrtar të Komisionit Evropian (DG AGRI), datë 31.05.2018 dhe 25.10.2018 është vlerësuar pozitivisht struktura e Autoritetit të Auditimit Shqiptar. Vlerësim pozitiv për këtë strukturë është dhënë dhe me letrën e Komisionit Evropian DG NEAR, datë 31/10/2018.

Autoriteti i Auditimit ka kryer një auditim sistemi gjatë vitit 2018, një auditim llogarish dhe auditim operacionesh si dhe ndjekje e rekomandimeve të dhëna nga DG AGRI për programin IPARD 2014-2020. Pagesat e Audituar nga data 1 Janar-31 Dhjetor 2018 janë audituar në shumën 7,149,943.85 EUR.

## **I. MISIONI I INSTITUCIONIT**

### **Misioni**

Autoriteti i Auditimit ka si objekt të veprimtarisë auditimin për sistemet e menaxhimit dhe kontrollit për veprimet, transaksionet dhe llogaritë vjetore të mbështetjes financiare të Bashkimit Evropian, për fondet para dhe pas anëtarësimit.

Autoriteti i Auditimit, nëpërmjet auditimeve, ofron siguri lidhur me sistemet e drejtimit, kontrollit të brendshëm, auditimit të brendshëm, mbikëqyrjes, kontabilitetit në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit, marrëveshjet kuadër, rregulloret e aplikueshme të Bashkimit Evropian dhe Strategjinë e Auditimit të Autoritetit.

### **Vizioni**

Vizioni ynështë promovimi i menaxhimit efektiv dhe llogaridhënies për të promovuar menaxhimin efikas, llogaridhënien dhe transparencën në përdorimin e fondeve të BE në Shqipëri në mbrojtjen e interesave financiare kombëtare dhe të EU.

## **III. VEPRIMTARIA E KËSHILIT MBIKËQYRËS TË AA**

Gjatë vitit 2018 Këshilli Mbikëqyrës i Agjencisë së Auditimit të Programeve të Akredituara nga Bashkimi Evropian ka realizuar mbledhjet lidhur me miratimin e rregullores së Këshillit Mbikëqyrës, miratimin e PBA 2019-2021 dhe miratimin e planifikimit strategjik 2019-2021 të Autoritetit të Auditimit.

## **IV. AKTIVITET E AUDITIMIT**

### **AUDITIMET E SISTEMIT**

**Niveli i Sigurisë së Marrë pas Auditimeve të Sistemit (i ulët, i mesëm, i lartë) dhe justifikimi.**

Autoriteti i Auditimit ka informuar Komisionin Evropian që gjatë auditimeve të sistemit në strukturat Zyra Mbështetëse e NAO, NF, CFCU, Njësitë IPA, dhe Zyra Mbështetëse e NIPAC kanë identifikuar disa gjetje me qëllim që struktura të punojë në mënyrë eficiente. Disa nga gjetjet e çdo structure janë si më poshtë:

#### **CFCU**

Bazuar në informacionin dhe dokumentacionin e siguruar gjatë ekzaminimeve të bëra në auditimin tonë ne kemi konkluduar se sistemet e menaxhimit dhe kontrollit në Sektorin e Menaxhimit të Prokurimeve në CFCU punojnë por disa përmirësime nevojiten

## **ZYRA MBËSHTETËSE E NAO**

Bazuar në informacionin dhe dokumentacionin e siguruar në konkludime që sistemet e Menaxhimit dhe Kontrollit në Zyrën Mbështetëse të NAO punojnë por disa përmirësime nevojiten.

## **FONDI KOMBËTAR**

Bazuar në informacionin e siguruar dhe ekzaminimet e bëra gjatë auditimit në konkludime që sistemet e menaxhimit dhe kontrollit në Fondin Kombëtar punojnë por disa përmirësime nevojiten.

## **ZYRA MBËSHTETËSE NIPAC**

Në fund të auditimit u konkludua që sistemet punojnë pjesërisht, përmirësime substanciale janë të nevojshme.

## **NJËSISTË IPA**

Bazuar në informacionin dhe dokumentacionin e dorëzuar gjatë misionit tonë të auditimit si konkluzion sistemet e menaxhimit dhe kontrollit punojnë pjesërisht, përmirësime substanciale nevojiten.

## **AUDITIMI I PËRZGJEDHJES SË TRANSAKSIONEVE**

Auditimet e transaksioneve janë kryer vetëm nga Autoriteti i Auditimit.

Sipas strategjisë së Auditimit në përzgjedhjen e transaksioneve për testim do të përdoret një përzgjedhje të vogël (më pak se 200), ose përzgjedhje jo-statistikore për të testuar 100% të transaksioneve. Për shkak të numrit të vogël të transaksioneve nuk është aplikuar përzgjedhja e popullatës në punën e kryer nga Autoriteti i Auditimit gjatë vitit 2017 dhe të gjitha transaksionet lidhur me kontratat, disbursimet dhe kostot ishin subjekti i auditimit. Verifikimet e Autoritetit të Auditimit kanë mbuluar 100 % të dokumentacionit të strukturave IPA. Auditimi i operacioneve është kryer për të parën herë për IPA I.

Nuk është përdorur përzgjedhja statistikore. Gabimi i projektuar është shuma e gabimeve të gjetura në mbledhjen e popullatës. Niveli i gabimeve do të krahasohet me nivelin e materialitetit për të gjithë popullatën.


#### **IV. ZHVILLIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE**

Autoriteti i Auditimit ka përdorur burimet e tij për auditimet e kryera në vitin 2018. Të gjitha burimet njerëzore, financiare dhe material të nevojshme për të kryer auditimet AA dhe për të përgatitur këtë raport janë siguruar dhe janë në përputhje me buxhetin e AA për vitin 2018 ku ndër të tjera numri i audituesve është katërfishuar në krahasim me vitet paraardhëse.

**STRUKTURA E RE E AUTORITETIT TË AUDITIMIT E MIRATUAR ME VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE Nr. 639, DATË 6.11.2017.**



ORGANIZATIONAL CHART  
AUDIT AGENCY FOR EU ACCREDITED ASSISTANCE PROGRAMS



**ANALIZA E NGARKESËS SË PUNËS 2018-2020**

Bazuar në supozimet Analiza e Ngarkesës së Punës pasqyron ngarkesën e punës të parashikuar për programet IPA I and IPA II, përfshirë IPARD. Bazohet në strukturën e re të AA të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.639, datë 6.11.2017 e cila është e harmonizuar sipas modelit të Autoritetit të Auditimit të Kroacisë dhe respektivisht analizon ngarkesën e Drejtorive të Auditimit për Programet IPA dhe IPARD. Kjo strukturë është audituar dhe trajnuar nga Komisioni Evropian (DG NEAR+DG AGRI). Struktura ka 7 auditues (drejtorin+3 auditues të parë dhe tre auditues të dytë). Lidhur me IPARD, 4 punonjës janë të punësuar aktualisht, dhe një

tjetër do të rekrutohet gjatë vitit 2019. Kjo strukturë është quajtur stabil dhe e konfirmuar nëpërmjet dy raporteve të Komisionit Evropian të përmëndura më lart.

### **IDENTIFIKIMI DHE RISHIKIMI I PËRSHKRIMEVE TË PUNËS**

Struktura organizative e AA, është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 639, datë 6.11.2017, ka krijuar poste pune të reja si rezultat i ri-organizimit të institucionit.

Përshkrimet e Punës të Detajuara për çdo pozicion janë caktuar sipas kuadrit ligjor të Autoritetit të Auditimit.

Përshkrimet e Punës përcaktojnë rolet dhe përgjegjësitë dhe autoritetin e çdo pozicioni. Kriteret e punësimit janë futurë në përshkrimet e punës për çdo pozicion në përputhje me Ligjin për Nënpunësin Civil 152/2013, i ndryshuar dhe Ligjin AA Nr. 90/2016.

### **KONSIDERATAT E STRATEGJIVE PËR REKRUTIM**

Autoriteti i Auditimit përdor teknika afatgjata dhe afatshkurtra rekrutimi.

Situata aktuale e imponon AA të përdori dy nivele audituesish: Të Parë dhe të Dytë. Kjo zgjedhje aplikohet me qëllim që të tërheqim kandidatë me cilësi të mira.

Megjithatë, aktiviteti i AA do të jetë për të nënvizuar progresin normal dhe punën, teknikat afatgjate do të jenë udhëzuesit tonë në procesin e rekrutimit. Kjo është thelbësore për menaxhimin e institucionit. Rekrutimi afatgjatë përfshin zhvillimin e marrëdhënieve me personat kryesorë dhe komunitetin ku punon AA, dhe promovon AA si një vend i dobishëm i nivelit të lartë për të punuar. Fokusi është mbajtja e lidhjeve afatgjate me njerëz të cilët kanë potencial për të punuar për Autoritetin e Auditimit.

### **POLITIKA E MBAJTJES SË STAFIT**

Politika e mbajtjes së stafit është një veprim i rëndësishëm për menaxhimin kundrejt identifikimit të punonjësve sipas angazhimeve në AA. Punonjësit kanë si objektiv kur punojnë për organizatën. Ata konsiderojnë që aktivitetet profesionale janë pjesë e zhvillimit personal. Profesioni jep kënaqësi me përfitimin e një page.

Situata aktuale e stafit të AA përshkruhet si më poshtë:

Nr.	Emri/Mbiemri	Pozicioni	Arsimimi	Punësimi në AA
1.	Alba Qirjazi	Drejtor i Përgjithshëm i AA	Financë/Audit	Tetor 2017
2.	Julja Mata	Auditues i Parë/ Drejtor i Drejtorisë së Auditimit për Programin IPARD	Finance/Drejtësi	Maj 2012
3.	Geisa Kerluku	Auditues i Parë/ Drejtor i Drejtorisë së Programeve IPA	Financë/Drejtësi	Maj 2012
4.	Zamir Kurushi	Auditues i Parë/Drejtoria e Auditimit të Programeve IPA	Finance/Audit	Maj 2017
5.	Marjeta Prendi	Auditues i Parë/ Auditues i Parë në Drejtorinë e Auditimit të Programit IPARD	Financë	Prill 2012
6.	Enkeleda Kambo	Auditues i Dytë/ Drejtoria e Auditimit për Programet IPA	Financë/ Programim dhe Monitorim	Shtator 2018
7.	Shefki Jaupi	Auditues i Parë/ Drejtoria e Auditimit për Programin IPARD	Financë	Nëntor 2016
8.	Lejda Frasheri	Auditues i Parë/ Drejtoria e Auditimit për Programin IPA	Ekonomik/Drejtësi	Shkurt 2017
9.	Eglantina Bardhi	Auditues i Parë/ Drejtoria	Financë	Mars 2017

		e Auditimit për Programin IPA		
10.	Marenglen Sinani	Auditues i Parë/ Drejtoria e Auditimit për Programin IPA	IT	Shkurt 2017
11	Gentian Leva	Auditues i Dytë, Drejtoria e Auditimit të Programeve IPARD	Jurist	Maj 2018
12	Rovena Husa	Auditues i Dytë, Drejtoria e Auditimit të Programeve IPA	Jurist	Maj 2018
13	Redi Cino	Auditues i dytë Drejtoria e Auditimit të Programeve IPA	Jurist	Dhjetor 2018

Për fillim të vitit 2018, vetëm 4 pozicione kanë mbetur vakante:

1. Nëndrejtor i AA
2. Një Auditues i dytë për Drejtorinë e Auditimit për Programet IPARD

Procedurat e rekrutimit për këto dy pozicione priten të hapen së shpejti nga Departamenti i Administratës Publike

## **PLANI I TRAJNIMEVE**

Komisioni Evropian i siguroi Autoritetit të Auditimit një kontratë me asistencë teknike për fuqizimin e kapaciteteve të autoritetit shqiptar të auditimit.

Sipas nenit 19 paragrafi 1 i ligjit Nr. 90/2016 për Organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Auditimit për Programet e Akredituara nga Bashkimi Evropian në Republikën e Shqipërisë (Autoriteti i Auditimit), Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Auditimit ka miratuar planin e trajnimeve.

Me qëllim të fuqizimit të kapaciteteve për të siguruar një kapacitet dhe nivel të lartë aftësish në kryerjen e llojeve të ndryshme të auditimit në përputhje me rregullat dhe procedurat e Bashkimit Evropian dhe Standarteve të Pranuara Ndërkombëtarisht për auditimin, dhe lidhur me detyrat qëduhet të kryen sipas planit vjetor të punës për IPA I për vitin 2018 dhe Strategjisë së Auditimit për IPA II 2018-2020, janë ndjekur trajnimet e mëposhtme për periudhën Janar-Dhjetor 2018.

Nr	Tema e Trajnimit / Trajnimi sipas Analizës së Nevojave për Trajnim	Periudha	Kohëzgjatja	Projekti	Vëndi
1.	Funksionet dhe Përgjegjësitë Kryesore të Strukturave IPA dhe IPARD, Autoritetet dhe Strukturat lidhur me kuadrin e kontrollit të brëndshëm (Shtojca A dhe B e Marrëveshjes Kuadër)	Janar 2018	4 ditë	DFC Kontrata 'Fuqizimi I Kapaciteteve të Autoritetit Shqiptar të Auditimit	Tiranë
2.	Trajnim Teorik për qasjen e auditimit për dhe kërkesat në përputhje me standartet ndërkombëtare të auditimit dhe Manualit të AA / Harta e Trajnimeve: A.5. Planifikimi Vjetor i Auditimit dhe Vlerësimi i Riskut A.7. Teknikat e Auditimit A.8. Dokumentimi i Auditimit dhe Arkivimi A.10. Raportimi i Auditimit	Shkurt 2018	5 ditë	DFC Kontrata 'Fuqizimi I Kapaciteteve të Autoritetit Shqiptar të Auditimit	Tiranë
3.	Auditimi i operacioneve, përfshirë verifikimet	Prill 2018	5 ditë	DFC Kontrata 'Fuqizimi I Kapaciteteve	Tiranë

Nr	Tema e Trajnimit / Trajnimi sipas Analizës së Nevojave për Trajnim	Periudha	Kohëzgjatja	Projekti	Vëndi
	në terren / Harta e Trajnimeve: A.3. Auditimi i Operacioneve A.6. Përzgjedhja e Mostrave të Auditimit. Materialiteti			të Autoritetit Shqiptar të Auditimit	
4.	FIDIC dhe kontrolli i prokurimeve fazat / Harta e Trajnimeve: A.3. Auditimi i operacioneve	Prill-Maj 2018	4 ditë	DFC Kontrata 'Fuqizimi I Kapaciteteve të Autoritetit Shqiptar të Auditimit	Tiranë
5.	Trajnime teorike për auditimin e sistemit duke përfshirë: - Hyrje në Auditimin e Sistemit - Auditimi i elementëve horizontal të kontrollit të brendshëm – COSO kriteret 1, 2, 4, 5 (IPA II FËA, Shtojca B) - Auditimi i aktiviteteve të kontrollit lidhur me strukturën menaxhuese të aktiviteteve të kontrollit lidhur me Strukturën Menaxhuese – NAO, Fondi Kombëtar dhe Zyra	Maj-Qershor 2018	15 ditë	DFC Kontrata 'Fuqizimi I Kapaciteteve të Autoritetit Shqiptar të Auditimit	Tiranë

Nr	Tema e Trajnimit / Trajnimi sipas Analizës së Nevojave për Trajnim	Periudha	Kohëzgjatja	Projekti	Vëndi
	<p>Mbështetëse e NAO</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Auditimi i aktiviteteve të kontrollit lidhur me strukturën zbatuese</li> <li>- Auditimi i aktivitetit të auditimit të brendshëm /</li> </ul> <p>Harta e Trajnimeve: A.2. Auditimi i Sistemit</p>				
6.	<p>Auditimi i Llogarive (IPA II) /</p> <p>Harta e Trajnimeve: A.4 Auditimi Financiar B.5 Kontabiliteti</p>	Qershor 2018	4 ditë	DFC Kontrata 'Fuqizimi I Kapaciteteve të Autoritetit Shqiptar të Auditimit	Tiranë
7.	<p>Funksionet dhe Përgjegjësitë Kryesore të Strukturave IPARD, Autoriteve dhe njësive lidhur me kuadrin e kontrollit të brendshëm dhe qasjen e auditimit /</p> <p>Harta e Trajnimeve: A.14. IPARD Metodologjia e Auditimit</p>	Maj 2018	5 ditë	DFC Kontrata 'Fuqizimi I Kapaciteteve të Autoritetit Shqiptar të Auditimit	Tiranë
8.	<p>Kryerja e Auditimeve për IT /</p> <p>Harta e Trajnimeve: A.15. Auditimi IT</p>	Korrik 2018	3 ditë	DFC Kontrata 'Fuqizimi I Kapaciteteve të Autoritetit Shqiptar	Tiranë

Nr	Tema e Trajnimit / Trajnimi sipas Analizës së Nevojave për Trajnim	Periudha	Kohëzgjatja	Projekti	Vëndi
				të Auditimit	
9.	Trajnimet në detyrë për Auditimet e Sistemit / Harta e Trajnimeve: A.2. Auditimet e Sistemit	Januar – Shkurt 2018	10 ditë	DFC Kontrata 'Fuqizimi I Kapaciteteve të Autoritetit Shqiptar të Auditimit	Tiranë / E pa specifikuar
10.	Trajnimet në Detyrë për Auditimin e Llogarive (IPA II) / Harta e Trajnimeve: A.4 Auditimi Financiar B.5 Kontabiliteti	Mars 2018	5 ditë	DFC Kontrata 'Fuqizimi I Kapaciteteve të Autoritetit Shqiptar të Auditimit	Tiranë
11.	Trajnimet në Detyrë për Auditimin e Operacioneve / Harta e Trajnimeve: A.3. Auditimi i Operacioneve A.6. Përzgjedhja e Mostrave të Auditimit. Materialiteti	Prill - Maj 2018	14 ditë	DFC Kontrata 'Fuqizimi I Kapaciteteve të Autoritetit Shqiptar të Auditimit	Tirana / Për tu specifikuar
12.	Trajnimet në Detyrë për IPARD / Harta e Trajnimeve: A.14. Metodologjia e Auditimit IPARD	Maj – Qershor 2018 (Subjekti i procesit të akreditimit)	15 ditë	DFC Kontrata 'Fuqizimi I Kapaciteteve të Autoritetit Shqiptar të Auditimit	Tirana / Për tu specifikuar



Nr	Tema e Trajnimit / Trajnimi sipas Analizës së Nevojave për Trajnim	Periudha	Kohëzgjatja	Projekti	Vëndi
13.	Vizitë Studimore për IPA dhe IPARD	Shtator 2018	3 ditë	DFC Kontrata 'Fuqizimi I Kapaciteteve të Autoritetit Shqiptar të Auditimit	Për tu specifikuar
14.	Trajnimet në detyrë për ndjekjen e rekomandimeve të Auditimit	Tetor 2018	3 ditë	DFC Kontrata 'Fuqizimi I Kapaciteteve të Autoritetit Shqiptar të Auditimit	Tiranë

## **V. STRATEGJIA AFATMESME E ZHVILLIMIT TË AUTORITETIT TË AUDITIMIT, SFIDAT PËR VITIN 2018**

### **STRATEGJIA E AUDITIMIT/PLANI VJETOR I PUNËS**

#### **PLANI VJETOR DHE STRATEGJIK I DORËZUAR NË KE PËR IPA 2014-2020**

Strategjia e Auditimit bazohet në një udhëzim për të kryer aktivitetet e auditimit për tre vitet e ardhshme.

Strategjia e Auditimit për Autoritetin e Auditimit mbulon aktivitetet e Auditimit për programin Përgatitja për Anëtarësim në BE dhe institucionet e lidhura dhe ngritja e kapaciteteve për programin Vjetor të Vëndit (ACAP).

- IPA 2015/038715-6/ Programi i Veprimit për Shqipërinë
- IPA 2014/032813/ Programi i Veprimit për Shqipërinë
- IPA 2013/024935/ Programi Kombëtar për Shqipërinë

- IPA 2012/023036/ Programi Kombëtar për Shqipërinë

Strategjia e Auditimit e mbulon gjithë periudhën e programimit dhe do të konsiderohet me aktivitetet e tjera të planifikuara përfshirë planin vjetor dhe planin e angazhimit.

Strategjia e Auditimit është përgatitur sipas kërkesave të nenit 12 të Regullores së Komisionit Evropian (EU) 447/2014, Ligjit NR.37/2015, datë 09.04.2015 “Marrëveshja Kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian për rregullat e zbatimit të asistencës së Komisionit Evropian në Republikën e Shqipërisë sipas Instrumentit të Asistencës së Para-Anëtarësimi (IPA II), i ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar, (Fletorja Zyrtare nr.66, datë 30.09.2015) dhe në përputhje me shtojcën G të Marrëveshjes Kuadër për IPA II.

Strategjia e Auditimit përcakton metodologjinë e auditimit dhe procedurat për të planifikuar aktivitetet e auditimit për programet. Strategjia e Auditimit është baza për të përgatitur planin vjetor të Autoritetit të Auditimit.

Alokimet Indikative Financiare për fushat IPA- Reforma në përgatitjen për anëtarisimin në BE dhe fuqizimin e kapaciteteve nëpërmjet Programit Vjetor të Veprimimit (ACAP) të paraqitura në tabelën si më poshtë:

Strategjia e Auditimit përcakton metodologjinë e përzgjedhjes së kampionizimit të mostrave dhe përzgjedhjen e metodave të auditimit për veprimet dhe transaksionet gjatë planifikimit të auditimit.

Auditimet e kryera nga Autoriteti i Auditimit kanë si qëllim të verifikojnë:

- plotësisë, saktësisë dhe vërtetësisë së raporteve dhe pasqyrave/deklaratave financiare vjetore, si dhe të llogarive vjetore që mbështetin këto pasqyra/deklarata;
- funksionimit efektiv të sistemeve të menaxhimit, kontrollit e të mbikëqyrjes;
- ligjshmërisë dhe rregullsisë së transaksioneve përkatëse;

Strukturat dhe Authorities dhe Autoritetet që zbatojnë programe operacionale sipas fushës së politikave të IPA –Reforma në përgatitjen e anëtarësimi dhe fuqizimi institucional nëpërmjet Programit Vjetor të Veprimimit (ACAP). Subjektet e Auditimit të Autoritetit të Auditimit përfshijnë si vijon:

- NIPAC dhe Zyrën Mbështetëse NIPAC
- NAO

- Struktura Menaxhuese (Fondi Kombëtar dhe Zyra Mbështetëse e NAO)
- Struktura Zbatuese (CFCU, Njësitë IPA, Autoriteti Menaxhues, Agjencia IPARD)
- Përfituesit përdundimtar dhe përfitues të tjerë.

Në mënyrë të detajuar sipas ligjit nr.90/2016, dated 15.09.2016 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian (Autoriteti i Auditimit) sSubjekt i auditimeve të Autoritetit janë të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme, individë dhe persona juridikë privatë që përfitojnë fonde të IPA-s dhe/ose të cilëve u kërkohet të kryejnë veprimtari që rrjedhin nga financimi i IPA-s. Këtu përfshihen:

- a) njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe çdo institucion tjetër që kryen funksione publike;
- b) përfituesit e drejtpërdrejtë dhe indirekt të fondeve IPA;
- c) shoqëritë shtetërore, organizatat jofitimprurëse dhe autoritetet e përbashkëta që zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantohen financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme, ose në të cilën një njësi e qeverisjes së përgjithshme zotëron apo kontrollon një pjesë të aksioneve, e cila i jep të drejtën e kontrollit;
- ç) njësitë e qeverisjes vendore;
- d) individët dhe personat juridikë private

Në zbatim në nenit 12 (1) të Rregullores së Zbatimit të Komisionit Evropian (EU) No. 447/2014 and klauzola 5 (1) e Shtojcës A të Marrëveshjes kuadër kur performohen aktivitetet e Auditimit Agjencia duhet të:

- a. Funkcionalisht e pavarur nga strukturat e menaxhimit të decentralizuar të akredituar nga BE dhe të zbatojë standartet ndërkombëtare të auditimit.
- b. Përgjegjës për verifikimin, efikasitetin dhe operacionet e sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit të asistencës.

Procedurat dhe metodologjia që përdor AA i referohen standarteve dhe prononcimeve në auditim, sigurim dhe etik nga bordi i Federatës Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC) dhe Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit INTOSAI :

- Bordi i Auditimit Ndërkombëtar dhe Standarteve të Sigurisë (IAASB),
- Standartet Ndërkombëtare të Etikës të Bordit për Auditimin (IESBA).

- Standartet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI, ISSAI-s
- Metodologjia e miratuar e përshkruar në detaje në Manualin e Auditimit IPA;
- Kuadri i rregulloreve të zbatueshme (aktet kombëtare dhe rregulloret e BE, marrëveshjet ndërkombëtare) dhe udhëzimet e zbatueshme të BE.

Të japë siguri që Agjencia kryen auditime në përputhje me këto standarte, programin e kontrollit të cilësisë i cili është krijuar për të vlerësuar operacionet.

Siguria e Përgjithshme për të lëshuar raporte dhe opinion mbulon, plotësinë, saktësinë dhe vërtetësinë e raporteve dhe pasqyrave të vitit financiar paraardhës dhe funksionimin e sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit dhe ligjshmëria dhe regulshmëria e transaksioneve do të bazohet në vlerësimin e besueshmërisë së sistemit (auditimet e sistemit) të kombinuar me rezultatet e auditimit të operacioneve dhe auditimit të llogarive.

## VI. RELACION PËR PASQYRAT FINANCIARE

Hartimi i Bilancit të veprimtarisë ekonomiko-financiare të Agjencisë së Auditimit të Projekteve të Asistencës, Akredituar nga Bashkimi Europian, për Vitin 2018, mbështet në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, nr. 8, datë 09.03.12.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. Postet e llogarive paraqiten si më poshtë vijon:

Llogaria 218, llogari të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara, pasqyron asetet e Agjencisë,. Në vlerën e AQT të paraqitur në bilancin e vitit 2018, janë shtuar pajisjet e blera me fondet buxhetore gjatë vitit 2018, si dhe diferencat e rezultuara nga inventarizimi të kryer në fund të vitit. Në zbatim të udhëzimit të lartpërmendur, AQT paraqiten në bilanc me vlerën neto. Gjithashtu në fund të vitit u krye inventarizimi i pasurisë së Agjencisë, nga komisioni i ngritur për këtë qëllim i cili raportoi punën e kryer në relacion përkatës.

Llogaria 212 dhe 215 përkatesisht “Ndertesa” dhe “Mjete Transporti” paraqiten me vlerën neto, ( Vlerës historike i është zbritur vlera e amortizimit të akumuluar deri më 31.12.2018)

Llogaria 202, në aktiv të bilancit me saldo 132.000 lekë, përfaqëson shpenzimet e kryera në vitin 2017 me fonde të planifikuara nga zeri “Investime”, për krijimin e faqes së WEB-it të Agjencisë.

Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)”, në shumën 2.344.562 leke, përfaqëson detyrimet afatshkurtëra të paraqitura në pasivin e bilancit, për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore, tatimet, blerjet dhe shërbimet e kryera në fund të vitit dhe të palikuiduara në fund të periudhës ushtrimore, por që likuidohen në muajin janar të vitit 2019.

Llogaria 520” Disponibilitete në Thesar”, paraqitet me saldo debitorë, në shumën 128.788 lekë, të cilat përfaqësojnë garanci kontrate për punime ndërtimore të kryera, para vitit 2016.

Llogaria 401 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, në vlerën 332.796 l lekë, pasqyron detyrime të krijuara para vitit 2016, në shumën 332.796 lekë, për të cilën nuk disponojmë fature të leshuar nga operator ekonomik.,

Llogaria 467, “Kreditorë të ndryshëm”, përfaqëson detyrime të krijuara dhe të palikuiduara para vitit 2016, në shumën 7434 lekë, ndërsa diferenca në shumën 86.586 lekë, përfaqëson fatura të muajit dhjetor 2018, të cilat Dega e Thesarit i ka kaluar për pagesë në muajin Janar 2019, me fondet buxhetore të vitit të kaluar.

Llogaritë 421 431,435,436, përfaqësojnë detyrimet për pagesën e punonjësve për :

- Pagat e muajit Dhjetor 2018
- Tatimet mbi të ardhurat personale, për muajin Dhjetor 2018
- Kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve, për muajin Dhjetor 2018 .

Në llogarinë 466 “ Mjete në ruajtje“, është përfshirë garancia e kontratës së punimeve të kryera, para vitit 2016, ngurtësuar në Degën e Thesarit, aktualisht e palikuidur.

Per vitin 2018, AAPAA i jane akorduar fonde buxhetore si me poshte vijon:

- Fonde për shpenzime korente 36.201.231 lekë
- Fonde per investime kapitale 3.261.000 lekë

Referuar situacioni vjetor të shpenzimeve, konfirmuar nga Dega e Thesarit, rezulton se janë kryer shpenzime me fondet e mesipërme për :

<b>I. Shpenzime korente gjithsej</b>	<b>32.540.031 lekë</b>
<b>Nga këto:</b>	
- Paga të personelit	17.973.922 lekë
- Kontribute të sig. shoqërore dhe shëndetësore	2.804.997 lekë
- Shpenzime operative	7.874.256 lekë
<b>II. Shpenzime per investime kapitale</b>	<b>2.485.276 lekë</b>
<b>Me analitikisht shpenzimet operative paraqiten;</b>	
Shpenzime per blerje materiale	554.680 lekë
Shpenzime transporti ,siguracione	1.195.594 lekë
Shpenzime udhetimi	2.668.806 lekë
Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	915.332 lekë
Shpenzime per sherbime nga te trete	984.850 leke
Shpenzime te tjera	1554.994 leke
<b>TOTALI</b>	<b>7.874.256 lekë</b>